

BESMIRA PELUSHAJ

**PËRPJEKJE TË ATDHETARËVE PËR GJUHËN DHE SHKOLLAT  
SHQIPE PASQYRUAR NË REVISTËN ALBANIA**

Mesi i shekullit XIX, që përkon me fillimin e lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, shënon edhe shtimin e përpjekjeve të atdhetarëve dhe rilindësve për lirinë e mësimin të gjuhës shqipe dhe për çeljen e shkollave shqipe. Një meritë e madhe pa diskutim iu takon organeve të shtypit, që propaganduan dhe protestuan ndaj situatës së rëndë në të cilën gjendej arsimi në vend. Ato synonin forcimin dhe afirmimin e popullit shqiptar nëpërmjet gjuhës, si tipari themelor që dallon çdo komb. Në këtë drejtim revista *Albania* (1897-1909) e Faik Konicës ishte një shkollë kombëtare, ku u kultivua jo vetëm mendimi arsimues e politik kombëtar, por edhe mendimi gjuhësor. E cilësuar si organi më i rëndësishëm dhe më me autoritet i Rilindjes, revista botohej në gjuhën shqipe, frënge dhe pjesërisht turke. Përmbajtja e saj shkon nga çështja kombëtare dhe politike tek problemet e gjuhës shqipe, të pajisur me një alfabet të përcaktuar, duke kaluar tek debatet, esetë, kritika letrare, përkthimet, tekstet poetike etj.

Në faqet e revistës, me të cilën F. Konica synoi bashkimin e shqiptarëve, zuri vend më së shumti çështja e gjuhës shqipe, duke u kthyer kështu në një referendum mbi formimin e një gjuhe të njësuar letrare. Aty u botuan studime për alfabetin, morfologjinë, terminologjinë etj. të cilat zgjojnë një interes të madh sot e kësaj dite. Revista *Albania*, shikuar në tërësi, ishte një shkollë ku u propagandua për bashkimin kombëtar një dhe të pandarë të shqiptarëve toskë e gegë<sup>1</sup>. Artikujt e botuar në revistë sollën forcimin e ndërgjegjes kombëtare te shqiptarët, që u shpreh me vetëdijen e tyre të përbashkët për përkatësinë në të njëjtin komb. Bashkëpunëtorët e Faik Konicës në revistën *Albania* janë figura të shquara të kulturës sonë kombëtare, si Mit'hat Frashëri, Filip Shiroka, Pashko Bardhi, Ndoc Nikaj, Mati Logoreci, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Milo Duçi, Viskë Babatasi e shumë të tjerë. Ndërsa nga dijetarët e huaj mund të përmendim albanologët botërorë më të njohur të kohës së Konicës, si Gustav Mayer, Ciro Truhelka, Holger Pedersen, Emile Legrand etj. Shkrimet e tyre e vunë revistën *Albania*, në pararojën e përpjekjeve, të cilat i dhanë frymë të re propagandës arsimore shqip të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Drejtimet kryesore të përpjekjeve të këtyre atdhetarëve ishin; përhapja e shkrimit shqip, pastrimi i gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të

---

<sup>1</sup> Muhamet Pirraku, *Faik Konica, jeta dhe vepra*, Prishtinë, 1997, f. 155.

panevojshme, pasurimi i saj me terma shkencorë e me fjalë të tjera të fjalorit abstrakt dhe përpunimi i disa normave gjuhësore.

Siç dihet, zhvillimi i lëvizjes politike-kulturore kombëtare ndeshi në pengesat e Perandorisë Osmane dhe e vetmja rrugë për ta luftuar propagandën antishqiptarë të saj ishte shtimi i presionit për përhapjen e shkollave shqipe kudo ku shtriheshin shqiptarët. Me gjithë pengesat nga qeveria turke, atdhetarët nuk i ndërprejnë asnjëherë përpjekjet për të përhapur arsimin në gjuhën amtare. Filip Shiroka (pseud. Geg Postriba), do të propagandonte në faqet e revistës për përhapjen e shkollave shqipe në Shqipëri, si e vetmja rrugë për ruajtjen e gjuhës shqipe. Ai drejtonte thirrjen për ndërgjegjësim dhe bashkim të gjithë shqiptarëve, për të mësuar në radhë të parë gjuhën shqipe dhe jo gjuhët e huaja: *“Asht koha me mendue se, po nuk punuemë të tan bashk, me gjith zembër e me gjith vullnes, për me dli, me qirue, me shëndosh e me lulëzue gjuhën ton, kurr nuk kena të drejt me ken të thirrur komb i qytetëruem, sado qi të msojm gjuh të hueja, sepse kombi nuk qytetërohet me msimin e gjuhve hueja, por me msimin e gjuhs vet”* (1897/12). Për Shirokën gjuha shqipe ishte sinonim i “kombit më vete” dhe simbol i fuqisë së tij dhe në emër të bashkimit mes shqiptarëve, ai do të propagandonte hapjen e shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë: *“Asht koha me kuptue se, po nuk e njallmë na vet gjuhën shqyp e po nuk e përhapmë me librat e me shkollat msimin e saj në gjith Shqypërin, kurr nuk kena me pasun at bashkimin qi ban fuqin”* (po aty). Edhe Pashk Bardhi (pseud. Pashmodko) në një artikull të tijin, duke iu bashkuar kësaj thirrje, shprehte bindjen se shumë shpejt shqiptarët do të kishin shkollat e tyre në gjuhën shqipe: *“... edhe shum kushi nër shqypitar ka nis me vështrve se shka asht gjuha e vet, e jan tuj e prit apshëm ditën n’ t’cillën njiher Shqypnija ka për t’i pas shkollat e veta n’gjuh t’vet”* 1901/3). Pashko, nëpërmjet këtij shkrimi ndalet të tregojë vlerat e shqipes dhe origjinalitetin e saj duke iu bërë thirrje të gjithë atyre *“qi ende jan t’verbum prej t’hollave t’hujve”* t’iu vijnë në ndihmë atdhetarëve që po punojnë për përparimin e shqipes dhe të atdheut.

Faik Konica në faqet e *Albanisë* iu krijoi mundësinë publicistëve shqiptarë për të luftuar jo vetëm propagandën turke por edhe atë serbe, greke e bullgare kundër hapjes së shkollës shqipe. Ai “i qortonte bashkatdhetarët e tij pse nuk ishin këmbëngulës në përpjekjet për shqiptarizimin e shkollave shtetërore osmane-turke në arealin tokësor shqiptar”<sup>2</sup>. Në të njëjtën linjë do të shkruante edhe atdhetari Lulo Frashëri, i cili do të konstatonte presionin e madh në të cilin gjendej Shqipëria: *“Sot Shqipëria është n’Evropë si një tok me plehë në një kopshtë me lule të bukura [...]. Bullgar’ i Maqedhonisë ja ka vënë synë, ka dhe një shoqëri të madhe, qi përpiqet nat’ e ditë për këtë punë. Greku po*

<sup>2</sup> Muhamet Pirraku, Mendimi arsimues e politik në revistën “Albania”, Faik Konica. *Jeta dhe vepra*, Prishtinë, 1997, f. 150.

*punon m'anë tjetër; ne, pse rrimë? Pse s'hapim shkolla në gjuhë shqip dhe të vështrojmë, të vemi mbroth e mos na shkelë kaqë ky tyran e barbar turku, se ndryshe do të humbasim e vdesim në baltë*" (1897/3).

Krahas luftës së ashpër ndaj propagandës antishqiptare të pushtuesit osman kundër shkollave shqipe, në revistën *Albania* do të lindte një tjetër betejë kundër përçarjes që sillte feja myslimane, në dëm të bashkimit kombëtar shqiptar. Lulo Frashëri bënte thirrje që shkollat shqipe të mos ngriheshim mbi ndasitë fetare, por mbi një ideologji kombëtare. Shkolla duhet të ishte një institucion laik, pasi kështu do të shërbente edhe si vatër e bashkimit kombëtar. *"Vëllezër, o burra, të mësojmë shqip, gjuhën e ëmbël tonë, se Zoti do mesim në. Kurani thotë: utlubul ilme velev fissini; d.m th "kërkoni diturinë dhe sikur të jetë në Kinë". Pa gjuhë, qysh munt të kemi dituri?"* (1897/3). Synimi i Lulo Frashërit ishte formimi i shqiptarët i ndjenjës së kombësisë, identitetit dhe individualitetit të tyre të veçantë përballë sundimtarëve të huaj: *"Po të kemi gjuhën tonë e diturinë, në vent të Shqipërisë do të mundim të rrojmë jo vetëm tre mijonë që jemi, po njëzet mijonë dhe si rrojnë njerëzit"* (po aty).

Në faqet e *Albanisë* do të zhvillohet një luftë e tërë kundër propagandës italiane, e cila nëpërmjet shkollave të saj kërkonte italianizmin e kulturës shqiptare. Duke parë ndikimin e madh të italishtes në gjuhën shqipe, pas përhapjes së shkollave në gjuhën italiane, Pashko Bardhi (pseud. Oshkab Idhrabi) propagandonte kundër kësaj politike dhe argumentonte pse nuk duhet të ndjekim më politiken e Italisë. *"Ne tash 3000 vjet na kan ra gjithfarë tallazesh mi krye, por gjuhën e fisin tonë s'e kena bierrun [...]. Jo, por për kunra, na ma fort kena me u trimnue, e me uzdaj t'Zotit gjuhën tonë kena me e qitë n'pah; e gjuhën taljane kena me e shqymë prej Shqypnijet"* (1899/6).

Është e njohur tashmë puna e Rilindësve për pastrimin dhe pasurimin e fjalorit, në kushtet e një prapambetjeje të gjithanshme të popullit shqiptar. Tejmbushja me fjalë të huaja dhe varfëria sidomos për fjalë të fushave të ndryshme të shkencës e të kulturës, nxitën përpjeket për krijimin e fjalëve të reja, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të gjuhës shqipe. Të tilla janë, p.sh., fjalët ndërgjegje, vetëdije, cilësi, sasi, folje, rrokje, përemër, atdhe, mëmëdhe, kryeqytet, qytetëroj etj. Konica, i vetëdijshëm për varfërinë e leksikut të shqipes dhe nevojën e tij për t'u pasuruar me fjalë të reja, i shihte huazimet si rrugën kryesore për të arritur pasurimin e leksikut. Me hapjen e rubrikës *"Fjalë të ra"* në revistën *Albania*, Konica do të propozonte fjalë të reja, jo vetëm të huazuara prej gjuhësh të tjera, por edhe krijime të vetë shqipes apo fjalë të hershme më përdorim të kufizuar nga një trevë në një tjetër. Por, veç kontributit të madh të Konicës për pastërtinë e gjuhës dhe pasurimin e leksikut të saj, do të veçonim edhe veprimtarinë e shquar të gjuhëtarit Aleksandër Xhuvani dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të *Albanisë* si Ndoc Nikaj, Filip Shiroka etj.

Aleksandër Xhuvani bëri një punë të vijueshme për pastërtinë e gjuhës shqipe, ashtu si edhe rilindësit, por pa teprimet e tyre të kushtëzuara edhe nga kushtet historike. *“Të mos e prishim gjuhën tonë me fjalë të huaja të panevojshme”*, kjo ka qenë porosia e përhershme e tij. Por, ai nuk ishte kundër çdo fjale të huaj, pasi huazimet gjuhësore janë një fakt i pamënjanueshëm si rezultat i kontakteve midis popujve. Xhuvani ishte kundër nxjerrjes jashtë prej gjuhës sonë të atyre fjalëve të huaja të përdorura prej popullit, që tashmë ishin pjesë e pandarë e shqipes. Fjalë si *bekoj - bekim (benedico - benedictio)*, *mallkoj - mallkim (maledico - maledictio)*, *dëshnim (testimonium)*, *virgjën (virgo)* etj., nuk mund të nxirren jashtë aq lehtë, pasi kjo nuk do të ishte në të mirën e gjuhës. Por, Xhuvani do të zhvillonte një luftë të pandërprerë ndaj fjalëve të huaja që janë futur në gjuhën shqipe pa nevojë: *“...përdorimi i frasis turqisht ‘jam pa qef’, mbasi në shqipet munet me u përkthye, asht fare i pa nevojshëm. N’Elbassan (e thom se dhe nëpër venet e tjera) përdoret frasi ‘jam si pa fuqië’, i cili munet me e përvendosë shumë bukur atë tjetrin turqisht. (1906/6). A. Xhuvani ishte i parimit që fjalët e huaja duheshin përdorur në bazë të nevojave që kishte gjuha për to dhe e vështroi gjithmonë pastërtinë e gjuhës në lidhje të ngushtë me pasurimin e saj dhe me ruajtjen e origjinalitetit. Theksoi shpesh nevojën e gjuhës për fjalë të reja, të krijuara nga brumi i shqipes apo të marra nga gjuhët e tjera. Ashtu si Konica, edhe ai ishte i mendimit se neologjizmat duheshin krijuar e përdorur në bazë të nevojave që kishte gjuha për to. Në shkrimet e tij, Xhuvani bëri një punë të madhe për të pasuruar gjuhën letrare me fjalë e ndërtime të reja.*

Çështjen e pastrimit të gjuhës shqipe nga ndikimet e huaja e ka shtruar në një artikull të botuar në këtë revistë edhe Filip Shiroka. Ai nëpërmjet këtij shkrimi fillimisht nxjerr në pah rëndësinë e gjuhës në zhvillimin dhe përparimin e një kombi dhe lartësimin e vlerave të tij: *“Sheji ma i pari me të cilin njifet një komb, asht gjuha që flet, sepse, sa ma mir ta flasim e ta shkrujmë gjuhën e vet, aq ma shumë dëftohet se që komb ka ecë në udhë të shkëlqyeshme e të dobishme të qytetërimit, në atë udhë që kanë kombet tjerë, për me rritë, me madhnue e me bukurue vetvedin, tuj msue, tuj dliu e tuj qirue gjuht e veta”* (1897/12). Shiroka ve në dukje ndikimin e madh të fjalëve nga turqishtja, italishtja apo sllavishtja, të cilat po zëvendësonin gjegjëset përkatëse në gjuhën shqipe, duke bjerrë kështu leksikun e saj: *“Nuk veç kemi qit mas shpinet gjuhën tonë, por edhe e kemi prishë, e kemi mjerue edhe e kemi përçudnue tuj harrue disa fjalë shqyp, e tuj përdorue shumë fjalë tjera nga turqnishtia, italinishtia edhe sllavnishtia”* (po aty).

Dihet se, futja e fjalëve të huaja të panevojshme në gjuhën shqipe e pengonte shumë të mësuarit lehtë të saj, pasi dihet që pjesa më e madhe e popullit ishte analfabet. Në këtë këndvështrim, Shiroka do të bashkohej me ideologjinë e rilindësve për pastrimin e leksikut nga elementët e huaja, duke i zëvendësuar ato me elementë të shqipes. Zëvendësimi i fjalëve të huaja me

fjalë shqipe u bë nëpërmjet fjalëve të mbledhura në truallin amtari (fjalë të harruara të shqipes) dhe me fjalë të krijuara nga brumi i shqipes. Duke iu bashkuar përpjekjeve për pastrimin e shqipes, Shiroka sugjeronte shqipërimin e termave të huaj, duke krijuar edhe sisteme termash vetjakë shqip për fusha të caktuara. Në mbështetje të kësaj ideje, edhe Lulo Frashëri do të shprehte bindjen se fjalët e huaja mund të dëboheshin shumë lehtë nga shqipja, nëse do të punohej për pasurimin dhe zhvillimin e saj: “... *m’ e bukur, m’ e lehtë, m’ e gjere se gjuha jonë s’ka nonjë tjetër; gjer më tani s’është e punuarë, pa po të punohet, fjalat e huaja do të dëbohen lehtëzi*” (1897/3).

Edhe Ndoc Nikaj do të pajtohej me ideologjinë e rilindësve dhe do të propagandonte pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme dhe zëvendësimin e tyre me material leksikor e frazeologjik nga të folmet ose me fjalë nga dialektet e shqipes. Sipas tij, gjuha shqipe duhet të mbante lidhje të ngushta me gjuhën e folur të popullit dhe të mbështetej në të: “...*due me thanë qi toska, ku t’gjejnë n’ t’folme t’vet fjalë t’huejat t’ i shporrin vehtiet e ma s’parit t’mledhin prejë motrës vet gjith ata fjalë, qi i mungojnë n’veti, e ashtu edhe gega me toskë*” (1902/3). Fjalët e huaja nga greqishtja, italishtja, turqishtja, sllavishtja, sipas Nikajt, duheshin nxjerrë nga gjuha shqipe sa më parë, pasi e dëmtojnë atë. Por duhet thënë se purizmi i tij shkon deri në një farë mase, pasi duke qenë i bindur për varfërinë e leksikut të shqipes, ai do të sugjerojë edhe huazimin nga gjuhët e huaja, gjithmonë kur ky është i nevojshëm: “... *n’gjuhë dietare t’qiten m’anët fjalët e hueja, qi na kan pshtiellue gjuhën tonë, sikurse greqishtja, turqishtja, italishtja, sllavishtja eti., e kur t’na shtërngojnë nevoja me marrë nonji fjalë prejë gjuhve tjera (qi mjerisht sot për sot shumë heresh na ‘nolle), gjith ç’ t’na lypet ta kërkojmë e ta marrim veç vetëm prejë gjuhve t’vjetra, qi nër dietarë kan parin e n’viëtrim t’vet munen m’ u kapë me t’viëtrin komin tonë*” (po aty).

Vlera e këtyre artikujve të sipërpërmendur dhe çështjeve të trajtuara në to është padyshim një kontribut i madh në rrugën drejt njësimit të gjuhës shqipe, zhvillimit të arsimit dhe bashkimit të kombit shqiptar. Revista *Albania*, nëpërmjet këtyre botimeve, i dha një frymë të re propagandës arsimore shqip të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

#### BIBLIOGRAFI

- Dhimitër Fullani, *Ashtu si e pashë Faik Konicën*, Tiranë, Eurorilindja, 2001.  
Ethem Likaj, *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*, Morfologji Historike, Tiranë, 2006.  
*Faik Konica, jeta dhe vepra*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997.  
*Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.  
*Konferenca shkencore për Faik Konicën*, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006.  
Kristina Jorgaqi, *Mendime Gjuhësie*, Tiranë, Ombra GVG, 2007.

- Luan Starova (përgatitur nga), *Një miqësi evropiane, Faik Konica dhe Guillaume Apollinaire*, Tiranë, Onufri, 2001 (bot. I, *Faik Konitza et Guillaume Apollinaire, Une amitié européenne*, Paris, L'esprit des Péninsules, 1998).
- Luan Starova, *Kthimi i Faik Konicës*, Shkup, Flaka, 2001.
- Miço Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2000.
- Namik Resuli, “Faik Konica në qindvjetorin e lindjes”, në *Faik Konica (1876-1976), Seminar studimesh me rastin e qindvjetorit të lindjes së Faik Konicës*, New-York, Kolonja Press, 1976.
- Palok Daka, *Fjalor pseudonimesh (1743-1944)*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, Shkenca, 1998.
- Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1986.
- Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe, Histori e alfabetit*, Shkodër, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Sektori shkencor i Albanologjisë, 1999.